



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA SEANCA e XII-të e RREGULLT e KUVENDIT të KOMUNËS së VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z. Naim Pira . Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 24.12.2015(e enjte) në ora 10,⁰⁰. Në seancë prezantuan 27 anëtarë të Kuvendit. Në seancë ishin prezent Nënkryetari i Komunës Z.Hasan Aliu, Drejtorët e Drejtorive, , përfaqësuesi i OSBE-së, organizata joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi . Para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si Kryetarin e Komunës Nënkryetarin e Komunës, Këshilltarët e Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive, Përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së XII-të të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë,

Fillimisht pasi është fundi i vitit për festat e fund vitit ti uroj të gjithë besimtarët katolik për festat e tyre dhe që viti tjetër të jetë vit i realizimit të aspiratave dhe dëshirave të tyre , do dëshiroja pasi është seanca e fundit për këtë vit të kursemi nga fjalimet dhe të kishim hy në pikat e rendit të ditës , para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës kisha lut këshilltarët a ka kush ndonjë pyetje apo ndonjë propozim fjala është për ju :

Znj. Mirlinda Sadiku . përshëndetje për të gjithë kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë , se fundemi ka qenë një reportazh në Klan Kosova me sa e di unë që janë ekzekutuar 55 krahë lopë për shkak që janë të infektuara nga tuberkulozi a paraqet kjo hapsirë shqetësim sepse e dimë që Vitia ka gogja një numër të caktuar të fermave ndoshta pyetja ju drejtorhet edhe drejtorit të inspeksionit se edhe ai është prononcua për media .

Z. Bekim Azizi . kisha pasur një pyetje e përcjella një konkurs për një shofer për ndihmën e shpejtë për QKMF-në , 11 shofera janë edhe nja me marrë e pash se është me rehatua një me kontratë mbi vepër që ishte besoj se drejtori tregon ma mirë a nuk mjaftuan 11 shoferat që janë aty , edhe një pyetje qe 2 muaj rëntgeni nuk punon te QKMF-ja nuk është ndonjë vlerë e madhe pse mos me u rregullua ndërsa pasi bëri kërkesë kryesuesi nja dy kërkesa që i kam pas tash nuk po i përmendi besoj se vitin e ardhshëm do ti bini .

Z. Adnan Ymeri . Kryetari nuk koka prezent un i kam disa kërkesa që kam me i adresua por po ua adresoj qeverisjes komunale , së pari ju uroj për punët e kryera deri me tani në komunën e Vitisë dhe për realizimin e projekteve të cilat i keni paraparë të i kryeni deri me tani . un kisha dashtë ti shprehi disa shqetësme që kanë të bëjnë drejtë për se drejti me jetën e qytetarëve të fsh. Sllatinë , së pari po e cekim ndriçimin publik që i mungon këtij fshati , pastaj projekti i ujësjellësit i cili nuk ka përfunduar , gjithashtu oborri i shkollës është bërë një pllak betoni për sallë të sportit dhe aktivitete tjera kulturore e njëjta ka mbetur pa u përfundua nuk është marrë asnjë hapë që mos të shkoj gjithë ai investim kot , janë edhe disa qështje tjera që pretendojmë

me i shprehur jemi të interesuar me punua aty mirë po nuk kemi parë ndonjë iniciativë kërkoj se vitin e ardhshëm të shikohet dhe mos të mbesin këto gjëra anash se po mbet Sllatina jo si vrimë e zezë e investimeve po të paraqet një qeverisje të arsyeshme për këtë fshat .

Z.Bislim Bislimaj . un desha me hy pak në situatën që është krijuar pas vendimit të gjykatës kushtetuese na muajin e kaluar u merrem me këtë qështje dhe falënderimin ua kushtoj të gjithëve që kanë kontribua mu merr ky vendim kështu opozita po edhe pozita në atë kuptimin nuk ka hezituat për me tregua të verteten qysh e mendon ajo shtetin , shyqyr prej zoti që është bërë kështu dhe nuk është bërë ma keq kam dëshirë që të ju shohë të gjithëve bashkë unik në betejat e ardhshme të reja dhe në fitore të reja së bashku , për të gjithë ata se kanë gabua ishalla kurr ma nuk gabojnë kësisoji për ata se kanë dhënë kontribut le të japin prap , edhe një herë ju uroj qytetarëve të gëzuar festat e fund vitit .

Z. Ali Bajrami. kisha pas dy pyetje për drejtorin e arsimit ; 1, sa kamerajanë vendosur nëpër objekte shkollore dhe 2 . sa puse me donatorë janë qel nëpër shkollat e komunës së Vitisë , meqë është seanca e fundit për vitin 2015 kisha pas vetëm nja dy-tri fjali në lidhje me këtë fund vit , pushtetin lokal e kisha nda në tri pjesë : kryetar , legjislativ , ekzekutiv, për zyren e kryetarit kisha pas urime për punet që i ka kryer , për ekzekutivin angazhimin që e ka tregua dhe për legjislativin që kemi bë që të kemi përformacë shumë të suksesshme me propozim vendimet , rregulloret dhe ajo qka është ma kryesorjavotimin e buxhetit që na ka bë të munder që komua e Vitisë ta ketë një përformacë kaq të mirë edhe të suksesshme

Z. Sejdi Emini . nuk e pata ndermend me fol por dyqysh e kam marr si shprehi sun po rri besoni , deshtem mos me hyr sot me rrespektua edhe kryesuesin mos me hy shumë në gjërat e ma hershme sepse me të vertetë është seanca e fundit dhe pikat e rendit të ditës janë pak ma relaksuese , nëse dojna mi marrë sendet shtruar duhet me gjykua drejtë së pari me ja nisë me gjykua prej vetëvete e tani me dal tutje ma larg , në këtë qeverisje 2 vjeqare ka vend për dy opsione dhe për dy hapsira ka vend për punet që janë bërë por ka vend edhe për kritikrat që janë bërë , un mendoj se vitin e ardhshëm kjo qeveri duhet me reflektua ma ndryshe , pasi dola po e bëjë një pyetje edhe te drejtori i arsimit shumë herë është fol se shkollat kanë kanë mbetur mangu me paisje rekuizita sportive mjete gjeometrike , e shumë të tjera kohet te fundit na kanë ardhë disa mjete gjeometrike un ma shumë i kisha quajter lodra sesa që kanë ardhur mjete mu kanë në sherbim të shkollave nuk e di kujt ju kanë dhanë ato pare por e di se ato që janë ardhur janë me cilësi shumë të dobëta dhe po me duket se paret po shkojnë huq , në këtë fund vit ju kisha dëshiruar edhe unë suksese në punë familje dhe në shendet dhe viti ardhshëm ishalla është ma i mirë për gjithë .

Kryesuesi . pasi nuk ka tjerë për të diskutuar u ju falenderoj të gjithëve për pyetjet e parashtruara dhe kisha lut drejtorin të japin përgjigjie në pyetjet e parashtruara ;

Z. Skender Ahmeti . ishte një pyetje që e bëri Mirlinda ja adresoj drejtorisë së bujqësisë po pasi un kam qen i involvuar në këtë proces desha të jap edhe përgjigjjen ma të saktë për arsye se jam merr me rastin , është një smundje e cila ka qenë në fermat blektorale të komunës së Vitisë është fjala për smundjen e tëpërkulozës , në këtë program ka qenë edhe testi për turpokolizim të kafsheve dhe fatqësisht kanë da disa kafsh me test pozitiv dhe janë marrë masa të asgjeshohen smundja për të cilen aludohen që janë asgjësuar kafshet është kjo smundje e cila mbrohet me ligj dhe na si drejtorat i inspeksionit kemi qenë të involvuar në këtë proces e kemi bërë asgjësimin në mënyren ma të mirë të mundshme , kafshet të cilat kanë da pozitiv nëpër disa ferma të Komunës së Vitisë i kemi marrë dhe i kemi asgjësua , nuk është ndonjë shqetësim për qytetaret për shkakë se mund të ketë por testet të cilat kanë dal pozitive i kemi asgjësua , dhe po ju them se nuk ka rrezik për ndonjë epidemi .

Z. Qahil Sinani . pyetja është bë te kamerat është e vertetë se fondacioni Kosov- Luksemburg na ka ndimua me 13 shkolla për kamera , me këtë e kemi bërë që të jet siguria ma e madhe nëpër shkolla në jemi në Vzhdim të këtij projekti edhe vitin tjeter besoj se do të kryhen edhe 18 shkolla, ndërsa sa i përkt puseve të hapura është një shoqat e Arabisë Saudite që ka dhënë një

donacion për haojen e puseve në për shkolla edhe në shtëpi të shendetit , sa i përket mjeteve të konkretizimit ne jemi mangut jo vetëm me të po jemi mangu edhe me kabinete sidomos të fizikës , të biologjisë etj .

Z . Basri Aliu . po e njëftoj së pari se në qendren e mjeksisë familjare janë 9 shofer tash është hapur një konkurs me kërkesë të stafit menagjues të QKMF-së është kërkuar edhe një shofer përshkakë se po ngriten kapacitetet edhe është ndertua ambulanca në Pozheran tash na vynë kapacitete ma të mëdha edhe për anen e shoferëve , konkursi ka qenë i hapur kanë konkuruar dhe janë në procedur e sipër të mbylljes së këtij konkursi dhe pyetja e dytë ishte puna e rentgenit është e vertetë se vetëm me një pjesë punon rentgeni kemi një defekt dhe jemi duke u munduar që ta rregullojmë

Z. Samet Idrizi . shfrytzoj nga rasti të uroj vllëzrit tonë të besimit katolik festen e krishtlindjeve un nuk dashta me dal po mu kujtua se ka ndodhë një incident buker i rënd te shkolla Bafti Haxhiu ka pas therrje me thikë të nxënseve të klases së 9-të kërkesa jeme është të ketë kujdes se siq kamë informata aty mbajnë shumë thika , boksa të hekurit kështu që kërkoj prej drejtorit të arsimit dhe drejtorave të shkollave përkatëse të bëjnë kontrolla ma shpeshë në mënyrë se mos të na përseriten raste të tilla se aty një nxënës i shkollës ka qenë shumë në rrezik për jetë .

Z. Hasan Aliu . un ma tepër dola në shenjë falenderimi për kontributin për të cilin keni dhënë ju si pjesë vendimarrse gjatë vitit 2015 dhe me ju urua edhe shendet edhe suksese në vitin 2016 , konsideroj se gjithëher ka qenë se proceset të shkojnë përpara dhe me të vertetë qytetaret e komunës së Vitisë i gëzojnë ato të mira të cilat mund të dalin edhe nga ekzekutivi edhe me vendime të kuvendit , megjithatë un do të ndalem në aspektin e sqarimiti ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e këshilltarit nga PDK-ja ne e kemi formuar një komision është ka punon megjithatë un e kam pasur shpresen që do ta keni materialin në këtë seancë po për shkak të angazhimëve me siguri se në seancen e janarit do ta keni të kompletuar kërkesa nga këshilltari i LDK për investime në lokalitetin e vetë duhet ta flakim uniforem të dalim në aspektë pak ma të gjërë konsideroj se nuk ka vend për vrima të zeza ne kemi investuar në atë lokalitet megjithatë është e nevojshme edhe ndriqimi publik edhe gjitha ato por megjithatë ato shkojnë gradualisht projekt pas projekti dhe Sllatina do të jetë e përfshime dhe ne nuk guxojmë të ngrisim asi qështje , ajo që ka është mirë është se Vitia ka hecë përpara në të miren e qytetareve të komunës së Vitisë a ka vend për kritika ,do të ketë gjithëherë se bota është e tillë zhvillohet në atë formë dhe lindin ide tjera ma progresive të cilat duhet ti qojmë , por megjithatë ajo që un konsideroj që duhet të dini edhe ju se qështjet kanë hecë në adrsë të mirës dhe të pozitivitetit dhe shpresoj se edhe viti 2016 do të jetë edhe vit ma i mirë në këtë drejtim tu i pas parasysht edhe vendimet të cilat i ka sjell .

Kryesuesi . pasi nuk ka tjerë për të diskutuar për seancen e12-të të kuvendit kemi paraparë këtë

R e n d d i t e

- 1.Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e XI-të e Kuvendit Komunal të Vitisë**
- 2. Propozim vendim për pezullimin e përkoshem të nenit 21 dhe të nenit 13 pika 13.6 të rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba**
- 3. Propozim Rregullore për Taksa Ngrakesa dhe Gjoba .**
- 4. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e bustit të deshmorit Hoxhë Januz Zejnullahu në zonen kadastrale Gjylekarë**
- 5. Propozim Rregullore për vendosjen , ndertimin dhe largimin e objekteve të përkoshme në pronen publike .**
- 6. Draft Rregullore për dhënien e lejeve mjedisore komunale .**

A ka dikush rrethë rendit ë ditës ju lutem,

Z . Daut Xhemajli . te rendi i ditës mu dok jo mirë renditja e pikave duhet piak e tretë propozim rregullorja mu kanë pika e dzytë e rendit të ditës , edhe pika e dytë duhet me qenë pikë e tretë e rendit të ditës

Kryesuesi . atëher kush është që të miratohet ky rend dite me propozim ndryshim që dha y. Dauti , konstatoj s me vota unanime miratohet rendi i ditës , si pikë të par të rendit të ditës kemi **1.Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e XI-të e Kuvendit Komunal të Vitisë ,** hapim debat rrethë kësaj pike të rendi të ditës a don ta merr fjalen dikush

Z. Bekim Azizi .në faqen e para findit kur është diskutuar te rregullorja në arsim kemi paraqit gjat diskutimit që kujdestarit gjatë vikendeve dhe këtu është shkruar që kjo nuk është në rregull sepse në shkolla nuk e kemi të rregulluar kujdestarin , na kujdestarin e kemi të rregulluar nëpër shkolla mirëpo nuk janë të rregulluar kujdestarit nëpër festa dhe gjatë vikendeve , nëse nuk ka e hudhim në votim për miratim kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës : konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmeve miratohet pika e parë e rendit të ditë , si pikë të dytë kemi , **2. Propozim Rregullore për Taksa Ngrakesa dhe Gjoha .** ftoj drejtoin e financave që ta merr fjalen rrethë kësaj pike të rendi të ditës

Z.Ibrahim Rama . të nderuar këshilltar komunal para jush keni rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoha që janë një nder dokumentet kryesore që duhet ti ti përpiloj drejtoria për financa krahas buxhetit dhe rregullores mbi tatimin mbi pronë , ne si drejtori komplet jemi kanë të involvuar për përpilimin e kësaj rregullore dhe drejtorat e drejtorive përkatëse në kuadër që qeverisë së komunës , mos me ju marrë shumë kohë rregullore e keni para vete për pyetje përgjigjie jamë në dispozicion tu ndihëmoj

Kryesuesi . hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës a donë ta merrë fjalen dikush :

Z. Sami Demelezi . edhe un një falenderim për trajnimin që patem me DEMOS-in në Pejë gjë që konsideroj se ka qenë shumë i sukseshem dhe kemi mësur disa gjëra që nuk i kemi ditur po para se me shkua të tjerat kisha dasht mu ndal te neni 9-të ku është bërë një korigjim nga KPF-ja te pagesa e takses për parashkolloret ndërsa pasuesiqë pason po e lexoj nëse familja e ngushtë ka mbi dy studentë në shkollim dhe gjithashtu ka edhe tre anëtar të pa aftë për punë u zbritet tarifa prej 20% praktikisht do të paguaj vetëm 80% për mua është një diqka e pa kuptimtë prandaj konsideroj se kjo duhet të eliminohet vazhdojmë te neni 9.5 kemi propozua që të ndryshohet të lirohen prej pagese dhe fëmijet e veteranave po meqë na kanë bërë si shumë veteranë tash ka mbet në dilem ndoshta për atë por këtu kisha propozuar të lirohen nga pagesa fëmijet me aftësi të veqanta , faqe 10 neni 12 12,1,1 zona e parë zona e dytë zona tretë zona katertë ka qenë në dilem pagesa për vendosjen në pronat publike kemi propozuar që kjo tarifë të zbritet në 50% pastaj un e kam një dilem te neni 12.1.5 dhe neni 12,1,1,6 meqë me ujë të pijës menagjon kompania neve nuk e di qa na mbetet këtu për me pas këtë taksë dhe tu kthy edhe një herë te trajnimi që kemi pasur na është thanë nga demosi se propozuesit duhet të kenë parasysht se qfar taksa po propozojnë dhe cilat po miratohen dhe meqë miratohen ato kalojnë po thujse në ligj atëher nëse një taksë e paraparë në këtë rregullore nuk inkasohet atëher del seedhe shkelje e ligjit nga propozuesi dhe për me shkua te neni 16 faqe 14 për mua gjithashtu është një nen që nuk ka përmbajtje prandaj edhe në KPF kemi propozua që të eliminohet dhe për me kalua krejt në fund te objektet e përkoshme kemi thanë edhe në trajnimin që kemi qenë po edhe në KPF kemi thënë se nëse objekti i përkoshem ndertohet me material të fortë ai ma nuk është i përkoshem se vet materiali i fortë definon diqka tjetër dhe krejtë në fund është një punë që duhet me u përshendetur ne si grup parlamentar i LDK-së jemi pro kësaj rregullore

Znj . Vjollca Kadolli – Halili . un dola realisht vetëm me një propozim te drejtoria e arsimit te neni 9.2 pagesa e takses për femijet në qerdhe un kam një propozim nëse pajtohen me qit edhe në votim që të lirohen nga pagesat fëmijet e nënave vet ushqyese kërkoj nga kryesuesi që ta qes si propozim këtë vendim d.m.th nënat vetë ushqyese të lirohen nga pagesa

Z. Daut Xhemajli . është një rregullore që është bisedua shumë herë po e tha edhe këshilltari paraprak Samiu drejtorit që parashohin taksa duhet me pas parasysht se ato edhe duhet ti marrin

nëse nuk i marrin është shkelje kështu që ma mirë është mos mi paraparë diqka si taks nëse nuk mundesh me inkasua , në këtë kuptim na kemi fol edhe për nenin 13 për hapsirat për parkingun e automjeteve edhe kjo qështje në KPF propozuam që të rishqyrtohet apo të riformulohet ndryshe sepse nëse i parashohin gjitha këta taksa kështu si janë paraparë del se komuna duhet me pas punëtor që ti qet në teren edhe të inkasoj këto taksa edhe në këtë aspekt nuk a është mendua kërkoj sqarim që komuna ta bëjë këtë punë se në këtë formë qysh është propozua nuk lejohet shpallja në ankand po komuna vet e menagjon nuk e di qysh vetëm e di se komuna e ka veshtir me menagjua vet , neni 13.4 marrja e lejes për kyqje në infrastrukturë edhe në KPF kemi fol që ky nen po konsideroj se duhet me u shly se paku se për kyqjen në ujësjellës , kanalizim dhe në energjetikë taksat un e di se paguhen diku tjetër ,neni 14 ku është e rregulluar transporti i automjeteve të parkuara gabimisht ne kemi thënë se këtë punë e kryen policia ka kompani të kontraktume etj komuna nuk merret me këtë punë nëse nuk merret atëher nuk kemi pse me paraparë këtë nen këtu edhe e fundit po mendoj që neni 22 në KFP tham me u fshi drejtor nuk e di qa është ka ndosh me ne nëse është një vendim i KPF-së me u fshi në material të kuvendit nuk duhet me ardhë .

Z. Bislim Bislimi . edhe un kam një vrejttje te neni 18 është fjala për invalidet e luftes këtu ku është e përcaktuar me shkall 80% në praktikë nuk zbatohet prandaj ma merr mendja se ata e meritojnë edhe se janë 20% apo 30 % këta e meritojnë me u hekë nga kjo pagesë e automjetit për regjistrim prandaj kisha than që të mos caktohet shkalla e invaliditetit po vetëm invealid i luftës .

Z. Ekrem Abazi . këta koleget e mi folen për punë të mëdha folen për njerzit që kanë pare un po flas për qytetaret që nuk kanë pare po ja filloj te administrata për sherbimet e ndryshme që marrin qytetaret p.sh përpilimi dhe lëshimi i akt vdejeve 3 ero kisha propozua mu kanë dy ero lëshimi i qertifikatës familjare dy ero kisha propozua mu kanë një ero vendimi mbi ndyshimet e mëvonshme nga 5 ero mu bë 3 ero , leshimet mbi shpenzimin e varrimit dy ero të jetë një ero këtë po e themë se p.sh vendimet mbi ndyshimet e mëvonshme p.sh un vet pata para dy-tri ditëve një kërkesë me ndrrua një shkronjë në emrin tim le që kushtoj 11 ero po kish me aktvendime që dihet se pushteti i më parshem psh ti marrim disa shkronja që janë ma të njohura shembull hyseni ata e kanë shkruar iseni jo hyseni etj do me thanë maltretohen qytetaret për shkak të pushtetit të maparshem që nuk e ka shkrua qysh duhet emrin e një përsone , pika 5.1 deri 5.26 familjet që shfrytëzojnë ndihmë sociale dhe të cilat parashtrajnë kërkesë un mendoj se duhet të lirohen vetëm familjet që marrin ndihmë sociale se disave nuk ju takon se i bëjnë fëmija mbi 5 vite dhe nuk ju takon ose thotë : familjet që prashtrajnë kërkesë te zyra e kryetarit kjo për muan nuk ka kurfar lidhje kjo është pa vend total kërkesë zyra kryetarit nuk jep po jep ndihma momentale dhe kjo duhet të shlyhet sipas meje , këtu e pata edhe një pyetje p.sh te disa që lirohen thotë invalidet e luftës , familjet e deshmorëve ma dihet veterant e luftes dhe familjet e tyre të ngushta përsoneat me aftësi të kofizuara këtu nuk është a janë edhe familjet e tyre ajo , tjetra te katastra pronë dhe gjeodezi përcaktimi i kufijëve të parcelës psh nga 80 ero për një parcel prej sipërfaqës 50 ari kish apëropozua të bëhet 50 ero , te gjobat psh kush ka biznes 500 deri në 700 ero gjobë kjo është e pa logjikshme këtu kanë mu denua njerzit e varfer qe mbajnë familjen me bukë kisha propozua që denimi të jetë maksimum 200 ero jo ma tepër .

Z. Ali Bajrami . kjo propozim rregullore për taksa ngarkesa dhe gjoba që e kemi para veti është punuar mirë un kisha filluar me dispozitat e përgjithshme te neni një që me këtë rregullore të përcaktohet lartësia e taksave dhe tarifave ngarkesave dhe gjobave gjithashtu te neni 3 kjo rregullore përcakton organin që inkason të hyrat komunale në nivel të pagesave dhe mënyren e pagesës së tyre që është mirë që është specifikua dhe dihet kompetenca e kujt është inkasimi i këtyre ngarkesave tarifave dhe gjobave të drejtorive përkatëse , shumica e tyre qa paten me u thanë u cekën në bazë të diskutimëve edhe në KPF edhe të diskutimëve të ma hershme të gjitha ato qqë janë propozua me një mënyrë janë përfillë duke filluar prej drejtorisë të administratës disa gjëra që kanë mbet me siguri drejtoret janë konsultuar edhe me ligjin prandaj pa mundësia

ligjore që të bëhen korigjime zvoglime apo rritje kanë mbet në këtë shkall si që janë të cekura , këtu se ka qenë edhe një kërkesë prej së larti për lirim në drejtorin e administrates janë të përfshime edhe komunitet që është për tu përshendetur që edhe atyre tu bëjmë një qasje në dokumentacion pa pagesë , te DKRS-ja nuk isha ndal , te drejtoria e arsimit u cekën ato që janë ndryshua , drejtoria kataster pronë dhe gjeodezi këto taksa janë të rregulluara dhe janë konform udhëzimit administrativ nr. 08 /2014 më së tepërmi që kemi biseduar kemi biseduar për drejtorinë e shërbimëve publike besoj se drejtori është konsultua edhe me ligjin besoj që ato që i ka bërë ato ndryshme janë në harmoni dhe në përputhshmeri me ligjin , neni 13 pika 13.3 10 janë të specifikuara taksat për shfrytëzimin e hapsirës publike në bazë të zonave janë mirë zona parë 100% , e dyta 75% , e treta 50% de e katërta 25% , te drejtoria e financave nuk po ndalem te taksat , te drejtoria e shendetësisë vetëm isha nal te faqe 18 pika 5 medikamentet nga lista esenciale e afruar në barnatoren publike , tash sigurisht aty mendohet për receptin që shkon me marrë medikamente dhe paguajnë të gjithë apo ata që janë me asistenc sociale janë të liruar prej kësaj pagese aty prej 80 cent edhe pse është simbolike po megjithatë është mirë me u precizua , drejtoria e inspeksionit dhe të urbanizmit i , te urbanizmi pash këto tarifate që është vlera te të gjitha dy ero sigurisht është në harmoni me ligjin .

Z. Bekim Azizi . një pjesë e mirë e vrejtyeve vetëm janë përmirësua atje , te faqe 4 te drejtoria e arsimit kemi nenin 9.5 parashe vetëm lirim për parashkullor në qerdhe që janë mirëpo edhe aty e diskutuam lirim e të rriturëve të mësimi jo formal që është një problem kryesor që zakonisht te na shkojnë mas kërkesave në drejtori të arsimit marrin vertetima tani as vet nuk e dinë kush lirohet aty është mirë të ceket nga neni 9.4 duhet të lirohen fëmijet e dëshmorëve fëmijet e invalidëve veteranet përsone me aftësi të kofizuar dhe përsone me asistenc sociale un mendoj se duhet të plotësohet edhe neni 9.4 për lirim që nuk e keni paraprë këtu , te vendosja e antenave edhe aty e vëmë si vrejtye po nuk e pasi pa të arsyeshme un nuk e shohë të arsyeshme se antenat japin transmetim të valeve dhe transmetimi i valëve nuk ka rëndesi në cilën zonë jeni sepse furnizon me valë dhe nuk ka rëndesi a është në zonen e parë apo në zonen e dytë vetëm ka rëndesi a është në pronë private a publike edhe te neni 22 që duhet të heket patjeter përshkakë që është për vitin që jemi ndërsa rregullorja është për vitin e ardhshem .

Kryesuesi . dikush tjetër a ka , nëse nuk ka drejtor u shtrua një numer i pyetjeve urdhëroni

Z. Ibrahim Rama . me gjithë përpjekjet për eliminimin e vrejtyeve apo sugjerimëve që kanë ndodhë në KPF për këtë arsye edhe materialin e kemi lan të shpërndajmë të hënen me qëllim që të kompletohet me vrejtyet dhe sugjerimet që janë dhënë në KPF , un i kam thirrë të gjithë drejtorët ku kanë pas me bë ndryshime sipas propozimëve të juaja dhe me ju thanë të drejten 99% e ndryshimëve i kemi bërë , un edhe një herë ju kërkoj falje këshilltar për nenin 22 gabim teknik se ajo është dasht me u hekë , kurse për pyetjet a vrejtyet që i bëtë janë drejtorët e drejtorive që munden me ju ndihëmu .

Z. Isak Sadiku . e pata një përgjegjie në pyetjen e z. Ekrem Abazi këtu janë të cekura shumë mirë prej 5.1 deri në 5.6 kush kush janë të liruar nga këto taksa thuhet shfrytzuesi i ndihmës sociale të cilet parashtrojnë kërkesë për ndihmë financiare pranë drejtorisë për shendetësi dhe mirëqenie sociale dhe të zyrës së kryetarit të komunës d.m.th ata edhe se marrin ndihmë atyre nuk mund me ju muhua një e drejtë për me kërkua ata ndihmë momentale d.m.th kjo kërkesë qa bëhet bëhet pa pagesë mirëpo me u lriua prej kësaj ata duhet me dëshmu se janë me asistenc sociale , edhe te vrejtya tjetër që ishte kush janë të liruar prej kategorive dmth janë invalidet e luftës , familjet e dëshmorëve , veteranet e luftës dhe dhe familjet e tyre të ngushta .

Z. Basri Aliu . e kam një përgjigje për asambleistin z.Aliun cili e bëri për participimin për barëra të listes esenciale këtu janë të liruar të gjitha kategoritë të cilat nuk bëjnë pagesë edhe për shërbime shendetësore atëher janë të liruara edhe për fitimin e barërave të listes esenciale .

Z. Nexhmedin Jakupi . ne sii drejtori kemi pas problem ma së shumti me nenin 12 pika 1 leja për vendosjen e transmetuesëve përshkak se në rregulloren e vjeter kemi pas si pikë ku i kemi tatimuar pra i kemi ngarkuar me taksa për atë operatur që i kan pas vendosur antenat në

teritorin e komunës sonë dhe ato të ndara sipas zonave , vitin e kaluar e vetmja komuna jonë i ka detyruar dy kompanitë ma të forta që janë në teritorin e komunës sonë vala dhe ipko që të paguajnë taksë komunale për vendosjen e këtyre antenave ne kemi pas përproblem dhe ndoshta edhe kërkojë edhe nga ju një ndihmë rrethë furnulimit të këtij neni , si drejtori pajtona për largimin edhe të nenit 13 rrethë parkingjeve dhe për momentin janë të liruar , po ashtu pajtohen te kyqja në infrastrukturë aty duket se është bërë një gabim teknik , po ashtu ajtohemi se neni 14 të fshihet i gjithë pasi kjo rregulloet në formë tjetër po ashtu edhe nenin 16 të përmirësohet .

Kryesuesi . faliminderit drejtor po ashtu në këto momente na u bashkanxhit edhe kryetari po shfrytzojë rasti ta përshendesë , dikush tjetër a don me diskutua rrethë kësaj pike

Z. Daut Xhemajli . atëher për nenin 13 un kërkoja sqarime ose duhet të mbetet i tillë e të shtohet një fjali këto taksa të shërbejnë si referencë për paramasat edhe parallogaritë që do ti bëjë komuna për dhënien e tenderit në mënyrë që ta kenë një kriter ku komuna bazohet për me dhënë këtë hapsirë ose nëse të fshihet un kam kërkuar edhe më heret që qendra ri rregullohet qendra të lirohet prej kësaj lloj parkingu por megjithatë duhet të definohe mi nëse shlyhet duhet një komision që të mirret për dhënin e tenderit , nëse nuk shlyhet edhe këto paramasa shërbejnë si referencë për mi bë ato paramasa mund me i ndihmu komisionit për mos me dal jashtë konizave .

Z.Hasan Aliu . dy qështje janë të cilat un mendoj se gjithë ato që shtrohen nga anëtarët e kuvendit komunal janë ato të cilat i japin forcë kësaj rregullore , rregullore të cilën komuna e Vitisë për vitin 2016 do të varet buxheti i të hyrave vetanake pikërisht nga kjo rregullore megjithatë dy qështje të cilat un konsideroj duhet ti shtroj kur thoni jo sipas zona është një realitet se ato antena shpërndajnë val por megjithatë duhet ta kemi të kjart marrja me qera e hapsirës publike në Viti edhe në Debëllde ndryshon prandaj sipas mendimit tim duhet me ekzistua ai kategorizim ju jeni ata që vendosni por un mendoj se në atë formë me lënë është ma mirë dhe tjetra të cilën Dauti e shtron me plot të drejtë un e kam than edhe në KPF është mirë me ekzistua ato se ne jemi para dy varianteve jemi para variantit të cilit parkingun mundemi me ja dhënë dikujt me qera dhe që ti paguaj qera komunës po në rast se komuna vendosë për një formë tjetër me menagjua vetë atëher ato na vënë se kjo rregullore na duhet për një vitdhe nuk mundemi ta ndryshojmë rregulloren brenda vitit , atë kërkesën që e shtroi kryetarja e grupit të LDK –së konsideroj se shifet se pushteti është i përgjegjshëm edhe për nanat të cilat konsideroj që janë mbajtëse të familjës .

Kryesuesi . un mendoj se u diskutua mjaftë kjo rregullore , un meqë doktoresha propozoj që të hyjë kjo si aline se po e quajnë atëher kush është paraprakisht që ta votojmë që ato nana që janë mbajtëse të familjës të lirohen nga pagesa kush është që kjo aline të hyjë në rregullore , konsatatoj se me votatë gjithë të pranishmëve hynë kjo aline në rregullore , dhe tani po e qesim në votim rregullorem me vretjtet të cilat u dhanë ; konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmëve kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës . me qenëse kryetari na u bashkanxhit në seancë sigurisht për fund vit ka ndonjë fjalë

Z. Sokol Haliti . të nderuar këshilltar të kuvendit komunal qeveri e nderuar dhe ju të gjith të pranishëm në këtë sallë un nuk kam shumë fjalë për fund viti desha edeh të ju uroj festat e fund vitit dhe të ju falenderoj për bashkpunimin që e kemi bërë deri me tani që un e kam karakterizuar se njëri ndër vitet ma të suksesshme ky e ka bë bashkpunim horizontal edhe vertikal që e ke kemi pasur vertetë dhe desha disa njoftime të vogla është projeksioni i buxhetit qendror qoft rruga nasal –Remnik qoft rruga tjetër që e kemi përmendur me Kurbliq deri në Kaqanik qoft bashkpunimi tjetër që lidhet me Ferizaj nga Tresteniku qoftë hyrja në buxhet edhe e shkollës së Pozheranit ashtu edhe e palestres sa e kemi analiziua ne kjo e kap shifren 1 milion 860 mijë ero investime kapitale plus projeksionet që ne i kemi miratua kur i shikon të gjitha parametrat investimet do të shkojnë diku rrethë 4 milion ero , kjo është një e arritur e madhe për komunën tonë për këtë desha me ju falenderuar dhe me ju përgëzua edhe për një qështje tjetër ty kryesues dhe ju këshilltarëve përshkakë se i pash vendimet që u shpallet edhe vendimet e

seancave të fundit të rregullta nga MAPL prandaj ju përgësoj për këtë dhe ju inkurajoj se për këto dokumente që qeveria komunale apo dikaster apo drejtorit veq e veq i kanë paraqit para juve natyrisht ti përmirësjomë siqë e pas e propozim ndryshimet e rregullorës për arsye se janë në të mirë të qytetarëve , faliminderit shumë shendet urime edhe një herë për festat e fund vitit .
Kryesuesi . faliminderit kryetarë ne vazhdojm me pikat e rendit të ditës ;

2. Propozim vendim për pezullimin e përkoshem të nenit 21 dhe të nenit 13 pika 13.6 të rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba ndoshta këtë vetëm e diskutuam dhe e shterrem si pikë nuk po e sho të arsyeshme edhe drejtori me dal me diskutua po atëher po e qesim në votim , urdhëro Ekrem

Z. Ekrem Abazi. Propozim vendim rrethë kësaj pike un kisha propozua që kjo të vlej pre 01,01, 2016 deri me 30,12,2017 d.m.th të bëhet për dy vite se kjo ashtu ka mu bë se viti 2017 është vitë zgjedhorë me siguri na në fund të vitit të ardhshem kemi me votu kështu se po e votojmë për dy vite

Kryesuesi . faliminderit ka komuna që janë duke paguar taksat komunale është mirë se propozove një gjë të tillë por kjo është një vjeqare .

Znj. Selviye Rexhepi . dashta vetëm një plotësim këtu deri sa pezullohet neni 21 un kisha propozua që të pezullohet edhe neni 41 që ka të bëjë me gjobat pikërisht për arsye se gjobat bëhet për përsanat fizik dhe juridik që nuk i përgjigjen neni 21 .

Kryesuesi . shumë propozim me vend atëher drejtpër ta kemi parasysh këtë nëse nuk ka tjerë për të diskutuar e hodhim në votim për miratim ; konstatoj se me vota unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, si pikë tjetër të rendit të ditës kemi :

4. Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit të dëshmorit Hoxhë Januz Zejnnullahu në zonen kadastrale Gjylekarë , ftoj drejtoreshn ta merrë fjalën

Znj , Fatbardha Emini . Më lejoni që sot para jush të paraqes këtë propozim vendim, caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit të dëshmorit Hoxhë Jonuz Zejnnullahu, në zonën kadastrave në Gjylekar.

Në drejtorinë tonë është paraqitur kërkesa nga OVL-ja në Viti dhe këshilli fshatit, të cilët kanë propozuar parcelën me numër 1905, e cila sipas verifikimit është në pronësi të komunës dhe pas daljes në teren dhe pas identifikimit të lokacionit, propozoj që parcela me numër 1905/2 me sipërfaqe 185 metra katrorë, të caktohet si lokacion për ndërtimin e bustit të dëshmorit Hoxhë Jonuz Zejnnullahu. Materialin e keni marrë me kohë, për pyetje sugjerime jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi . Hapim debat rrethkësaj pike të rendit të ditës , a son ta merrë fjalën dikush ju lutem
Z. Nuredin Lutfiu . në bazë të kërkesës së këshillit të fshatit Skifteraj dhe organizatave të OVL të UÇK –së në Viti për vendosjen e bustit të heroit të kombit Hoxhë Januz Zejnnullahu në vendin e tij të lindjes ju është caktuar lokacionin për vendosjen e bustit të heroit në fjalë , pasi që vi nga ky lokalitet shfrytëzoj rastin për qeverisjen lokale për përgjigjen e shpejtë në kërkesen e këshillit të fshatit dhe organizatës së OVL të UÇK-së , ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim .

Kryesuesi . a ka dikush tjetër rrethë kësaj pike të rendit të ditës , pasi nuk ka e hedhim në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës : konstatoj se me vota unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim Rregullore për vendosjen , ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkoshme në pronen publike . ftoj drejtorin e urbanizmit që ta merrë fjalën rrethë kësaj pike .

Z. Ajet Sallahu . këtë rregullore e kemi kalua edhe në lexim të parë prandaj un kërkoj vetëm nëse ka ndonjë vrejtje apo ndonjë sugjerim mundem me ju nndihmua.

Kryesuesi . hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës a donë ta merrë fjalën dikush ju lutem , pasi nuk ka e hudhim në votim për miratim : konstatoj se me votat e shumicës dhe një apstenim miratohet edhe kjo rregullore , dhe si pikët të fundit të rendit të ditës kemi :

6 . Draft Rregullore për dhënien e lejeve mjedisore komunale . prapë ftoj drejtorin e drejtorisë së urbanizimit që ta marrë fjalën rrethë kësaj pike të rendit të ditës .

Z. Ajet Sallahu . po ashtu edhe për këtë rregullore gjitha procedurat kanë kalua për mos me ju marrë kohë për pyetje apo ndonjë sugjerm jamë në dispozicion tu ndihëmoj .

Kryesuesi . hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës a don ta marrë fjalën dikush ju lutem
Z. Adnan Ymeri . kam disa propozime dhe disa ndryshme të shprehëjes , te neni 12 transferimi i lejes mjedisore komunale po e lexoj pastaj po e bëjë propozimin në rast se aplikuesi për leje mjedisore komunale ose poseduesi i lejes mjedisore komunale planifikoj ta transferoj kërkesën ose lejen te ndonjë person tjetër trashëguës këtu duhet të hiqet trashigues duhet të lihet përfitues ose marrës i së drejtës për arsye se trashigues do të thotë quhet personi i cili fiton të drejtën nga personi i cili ka ndrruar jetë , edhe ma poshtë e kemi aplikuesi për leje komunale ose poseduesi i asaj leje dhe trashëguesi edhe këtu ptopozoj që të ndryshohet , tash te pika 3 e neni 12 kërkoj që kjo të jetë pika 4 ndlrsa pika 3 e neni 12 të jetë në rast se aplikuesi për leje mjedisore komunale ose poseduesi i lejes poseduese komunale vdes atëher këtë të drejtë e trashigojnë trashigimtarët e tijë .

Z. Ajet Sallahu . nuk do të thotë se vetëm kur vdes e trashigon po pasuesi i asaj që e vazhdon atë veprimtari edhe ai është trashigimtarë prandaj në atë kuptim edhe këtë nuk e kam bërë prej veti po këtë e kam marrë prej udhëzimit administrativ që është në të njejtën formë që na obligon për me bë në këtë formë

Z. Adnan Ymeri . trashigues janë vetëm ata persona të cilet e trashigojnë personin që ka ndrruar jetë do të thotë për së gjalli nuk kemi mbi ligjin për trashëgimi .

Z. Sami Demelezi . un dola me thanë se edhe në KPF kemi thanë edhe këtu kemi thanë se është një rregullore e punuar mirë dhe krejtë në fund urime festa e vitit të ri .

Kryesuesi . a don dikush tjetër ta marrë fjalën , nëse nuk ka atëher e hudhim në votim për miratim , kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës : konstatoj se me vota unanime miratohet edhe kjo pikë e rendi të ditës , me qense e kemi formuar grupin e grave dhe vertetë gjatë këtijë viti ka bërë një punë të shkelqyer që un si kryesues i kuvendit do doja ti falenderoja për angazhimin e tyre në të gjitha sferat e jetës e posaqerisht në ligjeratat e mbajtura nga doktorëshat e nderuara që i kemi këtu rrethë kancerit të gjirit këto kanë sjell para kuvendit një informatë ja kisha dhënë fjalën doktorëshës rrethë kësaj informate .

Znj. Gjlsime Qamili . un në emër të grupit të grave do ta paraqes në pika të shkurtra aktivitet që i kemi realizua si grupë gjatë vitit 2015 , grupi i grave është i përbërë prej këshilltarëve komunale që janë vetëm pjesë e këtij kuvendi OJQ-ve të komunës sonë si dhe shoqërisë civile gjatë këtij viti ky grup ka realizuar punët e tyre duke i nbeshtetur edhe duke ju falenderuar vullnetit punës dhe unitetit që ekziston brenda grupit , andaj ne si grup mendojm se nuk mund të ketë zhvillim demokratik të mirëfillt as ekonomik as kulturorë pa pjesëmarrjen e barabartë të dy gjinive në të gjitha proceset e shoqërisë , këtë e them nga fakti se pa një bashkpunim të mirëfillt me strukturat komunale OJQ-të e komunës sonë drejtorinë e arsimit shendetësisë zyrtarës për barazi gjinore këto aktivitete tona nuk do të jenë të fuqishme apo do të dalin të zbeta . të gjitha aktivitet që i kemi mbajtur pa e anashkalua asnjë janë të një rendsie të veçant , do të themë se ishim pjesë e takimeve të rregullta të organizuara nga OSBE-ja me tema të ndryshme të cilat i kontribonin edhe shoqërisë tonë , duke u nisur nga ajo se ma mirë është të prevenosh se sa të mjekosh ne si gup kemi ndërmarrë disa aktivitete gjatë muajit tetorë ku kemi realizuar projektin për analizen e papesitit falas për 30 gra të komunës sonë kjo është bërë me ndihmen financiare nga komuna jonë , me qëllim të vedijësimit të qytetarëve në luftë kundra kancerit të gjirit në kuader të muajit tetorë grupi i grave të Vitisë në koordinim me drejtorinë e shendetësisë mbajti ligjeratën në disa fshatra të komunës sonë ku pjesë e këtyre ligjeratave ishin një numer i madhë i grave dhe me nendoj se këto gra janë të informuara sa do pak me natyrën e kësaj sëmundje , pjesë e kësaj ligjerate ishte edhe doktorëshat e nderuar znj . Vjollca Kadolli-Halili dhe do të themë se gjithësej 15 ligjerata janë mbajtur në komunën tonë , në këtë muaj

realizuar edhe mamografin për 7 gra të komunës sonë falas po ashtu realizuar edhe ultrazën në qendren kryesore të mjeksisë familjare , kemi hartuar edhe planin e punës për vitin 2016 ku si grup aty kemi paraqitur qëllimin sfot analizen dhe aktivitet se besoj që gjatë këtij viti do ti realizojmë , krejtë në fund un do të them se ne si grup jemi duke punuar të inkurajojmë gratë që të marrin përgjegjësinë në sektor të ndryshem në fund do të ju uroj edhe festat e fund vitit ju deshiroj suksese dhe shendet.

Kryesuesi .Faliminderit doktoresh edhe një herë po ju bashkangjitemi urimit tuaj , me kaq po e mbyllim mirë u pafshim seancat e radhës.

Seanca përfundon punimet në ora 12 : 10

Procesmbajtës:
Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Z. Naim Pira
